



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2021:162428  
Datë: 25.06.2024  
Numri i dokumentit: 05859209

Ac.nr.8671/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Dr.sc. Rafet Haxhaj, kryetar dhe Burim Shala e Besnik Bislimaj anëtarë, me zyrtaren ligjore Fitore Isufi-Saraçi, në çështjen juridike të paditëses L. D nga Gjilani, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson K. S avokate nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson Burim Maliqi - Zyrtar Ligjor në Zyrën e Avokatit të Komunës së Gjilanit, me objekt kontesti kompensimi i diferencës në pagë për punonjësin me Licencim, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.949/2021 të datës 02.11.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24.06.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET si e pa bazuar, ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit - Drejtoria e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.949/2021 i datës 02.11.2022, VËRTETOHET

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I., të dispozitivit aprovohet në tërësi si e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditëses L. D nga Gjilani dhe detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit- Drejtoria Komunale për Arsim, që paditëses, në emër të kompensimit të diferencës në pagë për punonjësit me licencim-kualifikim me fakultet, për periudhën kohore nga data 22.07.2018 e gjer më dt. 31.03.2022, për 45 muaj, t’ia paguajë shumën prej 2,490.75 €, me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga dita e paraqitjes së padisë me datë 22.07.2021, e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Në pikën II., të dispozitivit detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit- Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore, në lartësi prej 260€, dhe atë për përpilimin e padisë 104.00 Euro, për një përfaqësim gjyqësor shumën prej 135.00 € dhe për taksë gjyqësore shumën prej 21.00 € në

afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbartimit të dhunshëm ligjor.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur pala e paditur, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës si e bazuar, të prishet aktgjykimi dhe të refuzohet në tërësi padia dhe kërkesëpadia si e pa bazuar apo të prishet dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rivendosje.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësja L. D ka parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Gjilanit me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditëses, në emër të kompensimit të diferencës në pagë për punonjësit me licencim-kualifikim me fakultet, për periudhën kohore nga data 22.07.2018 e gjer më dt. 31.03.2022, për 45 muaj, t'ia paguajë shumën prej 2,490.75 €, me kamatë ligjore prej 8% në vit.

Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike se: paditësja është e punësuar si arsimtare e biologjisë në SHFMU ‘...’ në Gjilan, njëjta, me kërkesë në procedurë administrative, i është drejtuar Komunës së Gjilanit-Drejtorisë së Arsimit në Gjilan, për kompensimin e diferencës në pagë me licencim. Paditësja ka përvojë pune 17 vite.

Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar me ankesë.

#### **Vlerësimi i Gjykatës së Apelit:**

Lidhur me ekzistimin e shkeljes esenciale të dispozitave të Ligjit për procedurën kontestimore, Kolegji i Gjykatës së Apelit gjen, se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk ishte i përfshirë as me shkeljet e pretenduara e as me shkelje esenciale neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, për të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Lidhur me gjendjen faktike të vërtetuar, kolegji i Gjykatës së Apelit gjenë se, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se paditësja L. D më 12.09.2015 ka mbaruar Fakultetin e bachelor i programit biologji-kimi dhe se është i pajisur me licencë të karrierës, niveli i rregullt. Gjykata e shkallës së parë gjithashtu ka gjetur se e paditura nuk i ka bërë pagesat paditëses lidhur me licencimin.

Lidhur me aplikimin e të drejtës materiale, Gjykata e Apelit gjen se e drejta e paditësit për pagesat lidhur me licencimin buron nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33, të datës 29.08.2008 i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023. Ndonëse paditësi në parashtrimet e tij, është thirrur në Kontratën Kolektive të Arsimit Para universitar është përcaktuar se: *“Me licencim fitohet e drejta në punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë : Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçar 27% e pagës Bazë”,* kolegji i Gjykatës së Apelit gjen se në nenin 2.2 të LPK-së, është parashikuar që: *“Gjykata i zbaton rregullat e të drejtës materiale sipas çmuarjes së saj dhe nuk është e lidhur me thëniet e palëve që kanë të bëjnë me të drejtën materiale”. Sipas nenit 2.2 kualifikimin juridik të kërkesës e bën gjykata, sepse vlen parimi fundamental **da mihi facta, dabo tibi ius [më jep faktin të jap të drejtën].***

Meqenëse baza juridike e kërkesëpadisë apo baza për kompensim për tu trajtuar kërkesat e tilla gjendet në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33, të datës 29.08.2008 dhe çështja e kompensimit të mësim dhënësve mbi bazën e kualifikimit (licencimit) duhet të trajtohet sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara me vendimin e qeverisë, i cili vendim ka qenë në fuqi deri me 06.02.2023<sup>1</sup>, kolegji gjen se meqë nuk krijohet ndonjë gjendje tjetër juridike, për të vendosur ndryshe nga sa është vendosur në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, në një gjendje të tillë të çështjes, kolegji i Gjykatës së Apelit ka vendosur që pretendimet ankimore edhe sa i përket të drejtës materiale të refuzohet si të pa bazuara dhe që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

---

<sup>1</sup> Shih Mendimi Juridik i Gjyktës Supreme GJ.A.Su.A 214/2023, i datës 05.10.2023.

Numri i lëndës: 2021:162428  
Datë: 25.06.2024  
Numri i dokumentit: 05859209

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 195 par.1 pika d) të LPK-së, është vendosur si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.8671/2022, me datë 24.06.2024

Kryetari i kolegjit - gjykatësi,

Dr.sc. Rafet Haxhaj